

VENDIM
Nr. 172, datë 4.11.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA” SHPK NR. 322, SERIA F15, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s, NR. 159, DATË 28.12.2015**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 8, nenit 9, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 4.11.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 116/9 prot., datë 2.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1067 prot., datë 22.10.2020, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 322, seria F15, miratuar me vendimin e Bordit nr. 159, datë 28.12.2015.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar. Në datën 11.6.2014 është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të biznesit” (QKB) dhe mban NUIS përkatës.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Sa më sipër, vlefshmëria e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike përfundon në datën 28.12.2020 dhe shoqëria e ka depozituar aplikimin e saj në ERE, brenda afatit që përcakton neni 16, pika 1, sipërcituar (datë 22.10.2020).

- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacioni për aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” “c”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht, që ka të bëjë me:

Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore:

Neni 9, pika 2:

- germa “d” (Vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata)). Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për të deleguarin përgjegjës.

Dokumentet financiare dhe fiskale, sipas:

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (Vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara, vërtetim që nuk ka detyrime). Do t’i kërkohet shoqërisë të dokumentojë në ERE kryerjen e pagesës ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Tiranë për kontributet, e cila, sipas vërtetimit, nuk përmban as kamatëvonesë dhe as gjobë.

Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas:

Neni 9, pika 4.7:

- germa “e” (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Shoqëria “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE marrëveshjen për sistemin IT që ka me *Microsoft*;

do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 10 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 306, seria FK15, të shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.10.2015, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 29.12.2020.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Pertrit Ahmeti